

Jeta e Beqarit (pjesa 3)

SEKSI DHE BEQARI

Mirë se erdhët miq. Jemi në pjesën e tretë të serisë “Jeta e Beqarit”. Tema e mesazhit sot është: Seksi dhe Beqari.

Ky mesazh i tretë është goxha i sikletshëm për mua. Nëse ka ndonjëri me shumë guxim, jam i gatshëm t’ia le vendin dhe të na flasë për këtë temë. Unë kam dashur prej kohësh të flisja për një temë të tillë, por gjithmonë kam nguruar, sepse më dukej si diçka e vështirë, diçka tabu, të flasësh për gjëra të tilla në kishë. Por e kalova këtë moment, dhe ja ku jam. Nuk ju siguroj që të gjitha pyetjet që keni në mendjen tuaj për seksin do të marrin përgjigje; ka mundësi që do t’ju dalin pyetje të reja që s’i kishit menduar. Por ndihuni të lirë të bëni pyetje, sidomos në kohën e kafesë, dhe ta vazhdojmë diskutimin bashkërisht për këtë temë.

Kur vjen puna për seksin, ka shumë mendime dhe opinione për këtë. Çdo njeri e ka një opinion të tij për këtë temë. Por opinionet tona janë të ndikuara në një masë shumë të madhe nga ajo që shikojmë dhe dëgjojmë për këtë çështje. Ja t’ju jap shkurt disa opinione për të cilat po lexoja këtë javë:

Ka njerëz që, kur vjen puna për këto muhabetet, flasin për tradhti bashkëshortore si diçka me të cilën një burrë mburret që ka shkuar me dikë tjetër. Ka histori të ndryshme të abuzimeve seksuale, të shitjeve të femrave për biznese të këtij natyre. Ka histori të tjera që martesat janë në gjendje të keqe sepse të dy partnerët kanë pasur marrëdhënie seksuale me të tjerë para se të martoheshin bashkë, dhe nuk u shkulet nga mendja ai person me të cilin kanë pasur marrëdhënie; i ndjek si hije, edhe pse janë të martuar me dikë tjetër. Ka histori të tjera të njerëzve që kanë vrarë veten sepse janë ndier fajtorë për të kaluarën e tyre seksuale. Ka histori të tjera të njerëzve që janë shumë të dhënë pas pornografisë në internet apo kanaleve X. Për të pesta këto mund t’ju tregoj një ngjarje që e kam dëgjuar ose lexuar vetëm këtë javë.

Ajo ku dua t’ia nis sot është: Pavarësisht se ku je ti nga ana frymërore me Zotin, apo ku je ti nga ana seksuale, une dua t’ju përgjerohem, lërimi për një moment opinionet tuaja — për këtë temë — dhe jini të hapur në mendjen dhe zemrën tuaj që Perëndia, me anë të letrës së Tij të dashurisë, Biblës, të na flasë sot. Le të lejojmë Frymën e Tij të vendosë disa të vërteta që do të jenë ndihmë dhe shpresë për sa i përket anës seksuale, dhe të shikojmë modelin që ka Perëndia për këtë çështje.

Ndoshta ndonjëri mund të jetë ofenduar sot. “Do flasim për seksin në kishë; çfarë u bë kisha, si kafeja e fshatit, mirë që s’na kanë sjellë ndonjë Digitalb me

hap kanalet X. Kisha është për muhabet serioz, jo për këto gjëra; s'kam dëgjuar ndonjë kishë tjetër që të flasë për seksin të dielën." Unë besoj se duhet të flasim, përderisa edhe Perëndia flet për këtë çështje në Bibël.

Po pse duhet të flasim për këtë gjë? Sepse për seksin flitet kudo. Në çdo shtëpi sot, shumica e njerëzve e mbajnë televizorin ndezur gjithë ditën; shikojnë skena sensuale, gjysmë lakuriq ose ndonjëherë edhe lakuriq krejt. Ka revista ndër më të shiturat, si "5 këshilla për seksin" ose "7 këshilla për këtë e atë çift" ose "marrëdhënie seksuale mes çifteve". E gjen në televizor, nëpër telenovela, filma, emisione, revista, kompjuter, nëpër lokale gjysmë të errëta, pa përmendur ndonjë "hotel" në thonjëza që funksionon vetëm për atë punë.

Kudo flitet ose tregohet për të. Po të shtypësh fjalën "God" (Perëndi) në Google dhe bën kërkim, dalin rreth 400 milion faqe; po të shtypësh fjalën "Sex", del dyfishi i faqeve.

Dua t'ju bëj një pyetje. Ne jetojmë në një kulturë të dominuar nga seksi. Dhe duket se kultura jonë, dhe jo vetëm e jona, kudo në botë, është më shumë e ndikuar nga seksi sesa nga Perëndia. Por, pyetja ime është kjo: A jemi ne më të lumtur? A janë njerëzit më të lumtur nga ky ndikim, dominim? A kanë njerëzit më shumë gëzim për shkak të kësaj? A janë lidhjet më të forta? Ky ekspozim i madh që po i bëhet këtij muhabeti, a po na ndihmon neve që të kemi më shumë intimitet?

Përgjigja për të gjitha pyetjet është JO. Njerëzit janë të stresuar. Njerëzit po provojnë të gjitha mënyrat, po bashkëjetojnë, po kryejnë marrëdhënie jashtë martesë, po shkojnë me shumë persona të ndryshëm dhe me asnjërin s'janë të martuar ose lidhur. Por pyetja është: a kanë ndonjë plotësim në jetët e tyre? Mendimet tona mund të kenë ndryshuar dhe mund të jenë ndikuar nga jeta në kohët e sotme në lidhje me kulturën seksuale. Por, cili është qëndrimi i Perëndisë, sepse Ai nuk ndryshon? Fjala e Tij ka parime që janë funksionale edhe pasi kalojnë vitet.

Shumë prej jush mund ta dinë se çfarë thotë Bibla për seksin. Ndoshta ti nuk ke ardhur këtu për të mësuar se çfarë thotë Bibla për seksin, por për të dëgjuar një herë pastorin... ndoshta për të parë nëse ka ndonjë këndvështrim tjetër për këtë temë.

Nëse do t'i hedhësh një vështrim të shpejtë Biblës lidhur me planin e Perëndisë për seksin dhe martesën, përfundimi është se Ai e sheh martesën mes një burri dhe një gruaje. Ky është plani i Perëndisë. Tani, qeveria jonë ka plane të tjera për martesat, por ato plane nuk përputhen me standardin e Perëndisë.

Le t'ju lexoj diçka nga Bibla. Tek 1 Thesalonikasve, Pali, autori i letrës, i shkruan kishës në Selanik që të kuptonin se çfarë donte Perëndia nga ata, e njëjta gjë që po bëj edhe unë sot me ju. Konteksti ishte i tillë që ata po jetonin një jetë imorale nga ana seksuale. Imoraliteti seksual nuk është diçka e re. Madje, nëse lexon për adhurimin pagan, do të shohësh se seksi dhe adhurimi pagan ishin pjesë të pandara. Në atë kohë nuk ishte e vështirë për burrat që të shkonin në tempuj për të adhuruar idhujt, sepse ishte një rrugë e dy punë; çdo tempull kishte prostitutat e tij, dhe kjo ishte pjesë e adhurimit pagan.

Por Pali u thotë: “Kur erdhi Jezusi, Ai vdiq në kryq dhe provoi se ishte Perëndia vetë, sepse u ringjall pas tre ditësh. Dhe ju keni vendosur të ndiqni Jezusin. Tani hiqni dorë nga adhurimi pagan i idhujve, sepse e vjetra ka shkuar dhe e reja ka filluar.” Ja si i fillon ai udhëzimin e tij, në

1 Thesalonikasve 4:3-5 *'Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet në shenjtëri dhe me nder, jo me pasione epshi, si johebre që nuk e njohin Perëndinë,'*

1 Thesalonikasve 4:7 *'Sepse Perëndia nuk na thirri në ndyrësi, por në shenjtërim.'*

Nëse e shikon me vëmendje, do të dallosh qartë se Pali ishte i drejtpërdrejtë. Dhe në këtë pasazh ka parime bashkëkohore nga të cilat mund të mësojmë edhe sot. Unë dua ta shikojmë me imtësi këtë pasazh sot.

1. Pranoje atë që kërkon Perëndia nga ti.

1 Thesalonikasve 4:3a *"Ky është vullneti i Perëndisë, shenjtërimi juaj, të jeni të shenjtë."*

Pra, e para, pranoje atë që do Perëndia nga ti. Po, çfarë do Perëndia nga unë? Bibla thotë që Ai do që ti të jesh i shenjtë. Disa nga ju po mendojnë, “A të dal një çikë jashtë unë, po më bie telefoni? Po jo more vëlla, unë isha me dy mendje kur erdha. Po thashë, hajt se po shkoj, se do flasim për seksin, po shkoj kot. Por s'erdha me qejf, dhe ky shoku thotë, 'i Shenjtë?' A është në terezi ky apo jo? Ky thotë, 'Bëj jetë murgu?' O shoku, jemi në shekullin 21. Shumë mendjengushtë më duket ky djalë, nuk ka për të ecur përpara shumë, ta garantoj unë. Le që ku vjen puna për gjëra seksuale, ku ka më njerëz të pastër, të gjithë janë përfshirë diku.”

Por ajo që dua të them unë është, pavarësisht se çfarë opiniononi ke ti për seksin, apo pavarësisht se në çfarë gjendje seksuale je ti, unë do ta them atë që thotë Bibla. Bibla na mëson që Perëndia do që ti të jesh i shenjtë. Dhe në mënyrë që Ai të të bëjë ty të shenjtë, Ai do që ti t'i lësh vend në zemrën tënde; Ai do të

ketë kontrollin e zemrës tënde. Prandaj Pali bën lidhjen mes shenjtërisë dhe mëkatit seksual, sepse ky lloj mëkati e pengon ëndrrën që ka Perëndia për ty. Perëndia ka një vizion për ty.

Dhe shenjtëria është proces; nuk do të thotë të jesh i përsosur. Jo, SHENJTËRIA ËSHTË PROCESI QË FILLON KUR PERËNDIA FILLON TË VËRË RREGULL NË JETËN TËNDE. Atëherë, kur ti e lejon, i krijon hapësirë Atij.

Hajde shikojmë vargun tek

Filipianëve 1:6 *'duke qenë i bindur për këtë, se ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezus Krishtit.'*

Kur ti i thua “Po” ftesës për ta pasur Jezus Krishtin në zemrën tënde, aty nis puna e Perëndisë në ty. Pjesa e dytë thotë se Ai do ta përfundojë, do ta vazhdojë deri në fund. Kjo është ideja e shenjtërimit. Ai do të vazhdojë të ndryshojë jetën tënde deri në fund.

Ideja është që Perëndia dëshiron që karakteri yt të reflektojë karakterin e Jezus Krishtit. Ai do që të na transformojë nga brenda—jashtë. Ky është procesi i shenjtërimit. Dhe ia vlen sepse jeta jote merr më shumë kuptim; ti zbulon qëllimin e jetës, dhe bëhesh një person i ri.

Për shkak të angazhimeve të ndryshme, takoj shumë njerëz të ndryshëm gati çdo ditë, dhe shumë prej tyre nuk janë të krishterë. Dhe kur ata flasin për jetën dhe dëshirat që kanë në jetë, janë të njëjtat gjëra që Perëndia dëshiron për secilin person. Nëse shikon atë që do një person, tamam, tamam, është ekzakt ajo që Perëndia do për të.

P.sh. njëri tha: “Unë dua të kem shoqëri të mirë.” Tamam, tamam ajo që do ai është të jetë i qetë, të mos rrijë të analizojë “Si do ma marrë ky, po i thashë kështu, po çfarë synimi ka ky që më vjen vërdallë?” “Dua shoqëri të mirë, që të jem i qetë.”

Tjetri tha: “Unë dua të kem shumë lek, por shumë, ama.” Por pas lekut, a e di se çfarë ka? Ai do siguri. Do të ndihet i sigurtë që kur nesër të ketë një hall, një problem, apo edhe për qejfin e tij, të mos ketë siklet, po të jetë i sigurt që do e bëjë atë që do. Pra, tamam, tamam ai do shumë siguri.

Tjetri tha: “Unë dua të jem në gjendje të kontrolloj të ardhmen time.” Tamam, tamam ajo që do ai është të jetë i lirë. Të mos i thotë kush, “Bëj këtë, bëj atë, shko në këtë punë apo shkollë.” “Jo, more vëlla, unë dua të jem i lirë ta zgjedh vetë të ardhmen time. Dua liri.”

Ndonjëri po thotë: “Ooo, na le me gojë hapur, sa i thellë qenke dhe ti, more pastor, se paskemi ditur fare. Mirë pra, meqe qenke kaq i zgjuar, o pastor, unë dua seks, vetëm kaq dua unë.” Ok, nëse ti mendon që ajo që do ti është vetëm seksi, tamam, tamam ajo që do ti është intimitet me dikë. Ti po ngordh për pak intimitet me dikë, vetëm ti dhe ajo/ai. Dhe kjo është thelbi i qenies tënde, sepse trupat tona janë të krijuar për intimitet fizik—më prek, më mbaj dorën, më përqafo, më mbaj afër, mu ngjesh afër. Trupi ynë i kërkon këto gjëra, sepse ana jonë e brendshme ngordh fare për pak intimitet. Dhe intimiteti do ngelet i pangopur nëse e ushqejmë me patatina e suflaqa.

Është shumë e lehtë për ta ngatërruar dhe shumë njerëz e ngatërrojnë seksin me intimitetin. Çunat hiqen sikur u intereson intimiteti sepse duan të shkojnë shpejt në krevat. Gratë hiqen sikur duan seks sepse shpresojnë të marrin intimitet. Thellë brenda çdo personi ndodhen nevojat bazë të njeriut. Të gjithë ne duam të njëjtat gjëra në jetë.

A e di se çfarë thotë Perëndia? “Unë e di se çfarë do ti, dhe e di sesi të çoj ty në vendin e duhur.” Por mëkati seksual e ndalon punën e Perëndisë në jetën tënde, në një mënyrë krejt ndryshe nga mëkatet e tjera. Bibla thotë që mëkati seksual është ndryshe nga mëkatet e tjera, dhe këtë nuk e thotë pastori, por Bibla.

1 e Korintasve 6:18-20 *'Largohuni nga kurvëria (nga mëkati seksual)! Çdo mëkat që kryen njeriu është jashtë trupit, po ai që kurvëron mëkaton kundër trupit të vet. A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkitni vetvetes? Sepse u bletë me një çmim! Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tuaj dhe në frymën tuaj, që i përkasin Perëndisë.'*

Asnjë mëkat nuk e ndikon kaq shumë trupin sa ky mëkat.

Ky mëkat nuk është në të njëjtën kategori me të tjerët; nuk është i barabartë, 1 gënjeshtër = 1 mëkat seksual. Dhe ne themi: “Po, Perëndia na e fal mëkatin kollaj, bëj mëkat, thuaj një lutje, dhe ja ku iku.” Si ato makineritë tek spitali, kam parë unë, që fut monedha dhe del porosia në fund, një kanaçe ose një gjë tjetër. Fut një lutje, dhe del falja, të fal Zoti dhe këtë herë.

A na fal Perëndia? As që vihet në dyshim. Ai na fal, ai mezi pret të na falë dhe të na pastrojë. Por ajo që dua t’ju them është se mëkati seksual është mëkat me M të madhe. Sepse pasojat e këtij mëkati janë të mëdha.

Pra, e para, çfarë do Perëndia nga ti? Perëndia do që ti të jesh i shenjtë. Ai do që të pushtojë jetën tënde, ai do që ta kontrollojë zemrën tënde. Prandaj, lejoje Frymën e Tij të ndryshojë dhe të transformojë nga brenda—jashtë. Sepse kjo është dëshira e Perëndisë.

2. Përkushtojtu planit të Perëndisë për jetën seksuale.

1 Thesalonikasve 4:3 *“të hiqni dorë nga kurvëria,” (të hiqni dorë nga çdo lloj mëkati seksual).*

Pra, unë duhet t’i përkushtohem planit të Perëndisë për jetën time seksuale. Dhe vargu thotë, “Hiq dorë, pastrohu, largohu nga çdo lloj mëkati seksual nëse do të ndjekësh modelin e Perëndisë për këtë çështje.”

A është e lehtë kjo gjë? Jo! A është plani i Perëndisë? Po. Po pse qenka plani i Perëndisë? Sepse Ai e krijoi seksin, Ai e shpiku, ishte ideja e Tij. Dhe Ai ka një plan për të. Ndoshta për dikë mund të jetë lajmi më i fundit. Po, Perëndia e krijoi seksin, Ai e shpiku. Nuk ishte ideja e një burri dhe një gruaje që po bënin prova deri sa gjetën se pse ishin ato pjesë të trupit. Jo, ishte ideja e Tij, e Perëndisë që nga fillimi. Dhe e krijoi për kënaqësinë e njeriut. Kur Perëndia vendos kufij për këtë punë, nuk është se Ai do që të heqë kënaqësinë. Jo, sepse kënaqësia është ideja e Tij. Ai i vendos kufijtë, limitet për të mbrojtur jetët tona; Ai vendos kufij që të sigurojë intimitet mes dy personave.

Dikush më tha, "Po mirë, nëse Perëndia është kaq i dhënë pas martesës, dhe Perëndia e ka kaq seriozisht në lidhje me seksin brenda martesës, me personin që do martohem unë, a nuk duhet ta provoj një herë veten, a jam i aftë apo jo? Sepse çdo gjë që blejmë ne e provojmë një herë. Shalqi me provë, s’ka besim. Ble një makinë dhe e bën një provë, jo më të marrësh një grua që do e kesh grua, mos ta dish si është kjo punë." Unë i thashë, "Dëgjo, që ti je i aftë, as që vihet në dyshim, sepse ti je mashkull. Po që je mashkull, je i aftë edhe po more një plakë. Edhe nëse nuk di, do të mësojë puna vetë kur të vijë dita e duhur."

Problemet që kanë çiftet, problemet seksuale, nuk vijnë si rezultat i aftësisë apo paaftësisë. Problemi i shumicës së njerëzve të martuar është se shumë çifte të martuar nuk janë më të virgjër natën e parë të martesës. Ata, kur martohen, bashkë me pajën, kanë edhe një valixhe me përvojat e tyre seksuale të mëparshme që i sjellin në martesë. Shumë rrallë, shumë shumë rrallë, problemet në martesë janë probleme fizike. Shumica janë probleme emocionale, mendore, të gjitha tek kjo valixhe. Pse? Sepse problemi më i madh i ynë është këtu, në kokë.

Ja, do jetë ndonjë dyshues këtu që po thotë: “Kjo është shkollë e vjetër, kjo është ide e gjyshes time, dhe ajo ka filluar të ndryshojë një çikë; kur shkoja me të dashurën, na lironte dhomën e vet. Po më habit ky njeri sesi flet kështu për kufizime seksuale.”

Nëse është kështu, kush më gjen mua një familje të shëndetshme nga ana emocionale, një familje të lumtur, që janë të gëzuar DHE që prindërit e tyre kanë pasur seks ose kanë bërë seks jashtë martesës? Po ma gjete vetëm një familje të tillë, që jetojnë pa kufizime seksuale, por që janë familje të lumtur. Nuk ka. Ajo që mund të tregoj unë janë qindra e mijëra raste çiftësh që po shtohen çdo ditë, që kanë filluar të kenë të dashur/ra të rinj pa dijen e burrit/gruas, dhe familjet e tyre shkatërrohen.

OK, OK, thotë dyshuesi, “Unë e kuptoj këtë, por ky është muhabet për të martuarit. Por unë nuk jam i martuar, kështu që më le rehat mua? Pse nuk duhet të bëj seks unë, unë beqar jam? Se thjesht veprim fizik është, nuk është ndonjë gjë e madhe.” Dhe unë besoj që kjo është gënjeshtër më e madhe që ekziston.

Më dëgjoni, ju këshilloj: nëse seksi është vetëm veprim fizik, bëni qejf, se nuk i dihet a ju vjen rasti më, shfrytëzo momentin. POR, por, unë jam i sigurt që në këtë dhomë këtu, shumica prej jush e kundërshtojnë me të madhe që seksi nuk është vetëm veprim fizik. Sepse kjo mund të vijë nga përvoja juaj; nëse do të ishte vetëm fizike, kujtimi do të harrohej, kujtimet e dhimbshme do të iknin nga mendja. Por në vend të kësaj, të gjitha përvojat e kaluara seksuale dhe të gjithë personat me të cilët një person ka kryer marrëdhënie, nuk hiqen nga mendja.

Pse nuk hiqen nga mendja? Sepse ky është modeli i Perëndisë që ata mos të hiqen nga mendja. Modeli i Perëndisë për seksin është që të jetë jo vetëm veprim fizik, por edhe emocional, mendor dhe thellë shpirtëror gjithashtu.

Pse nuk hiqet nga mendja? Sepse trupi dhe shpirti yt nuk janë të ndarë. Ti nuk mund t’i japësh trupin dikujt dhe të mos i japësh shpirtin. Kur ti kryen marrëdhënie seksuale me dikë në një mënyrë reale, ai/ajo dhe ti prekni pjesët më të thella të shpirtit, pjesët më të thella të qenies tënde si njeri.

Prandaj matematika që bën Perëndia për martesën është e tillë: $1 + 1 = 1$. Ky është seksi, ka si faktor vetëm 1. Ky ishte modeli i Perëndisë.

3. Përgatit një plan që ta kesh kur tundohesh

1 Thesalonikasve 4:4a “...secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet ... (çdo njeri le të kontrollojë trupin e tij).”

Po si kontrollohet trupi? Duhet të përgatitesh kur vjen tundimi. Sepse tundime të tilla ka kudo. Është e vështirë të thuash “jo” në një botë që të thotë “po” me zë të lartë fare. Nëse ti je beqar, tundimi më i madh që ti ke në jetë është seksi. Kam lexuar një anketë që thoshte se 90% e beqarëve thonë se tundimi i tyre nr. 1 është seksi. Së pari, nuk mbaj mend se çfarë tundimesh ishin 10% të tjerat, por është tundim për shumicën e të rinjve.

Prandaj, filloje me përkushtim tek Perëndia. Sepse Ai të thotë: "Unë dua të sjell shenjtëri në jetën tënde." Ai thotë: "Ma lër mua anën tende seksuale dhe unë do të ndihmoj të kalosh tundimet."

Shiko vargun e radhës. Besoj se nëse ke tundime të mëdha seksuale, duhet ta mësosh përmendësh këtë varg:

1 e Korintasve 10:13 *'Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveçse tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.'*

Perëndia do të japë një RRUGË DALJE, kjo është garanci nga Perëndia. Ai nuk do ta lejojë situatën të nxehet; do të sigurojë një rrugë dalje për ty.

Por më duhet një plan sesi të dal nga situatat e tilla tunduese:

1. **Unë duhet të di që jam mëkatar.** Duhet t'ia them vetes: "Unë nuk kam imunitet ndaj mëkatit." Kur jam vetëm, e di që kam dëshirë të mëkatoj. Unë, si pastori yt, nuk jam ndryshe nga ti; jam mëkatar dhe mëkati rri te porta, sepse edhe unë jam mashkull. Por ai mëkat mund të më shkatërrojë familjen dhe shërbesën, që janë dy gjërat më të shtrenjta të jetës time. Zemra jote mëkatore mund të bëjë atë që s'të pret mendja. Pra, e para, mos harro që je mëkatar.
2. **Kam ndjenja seksuale.** Nuk është gjë e keqe, sepse kështu je krijuar. Thjesht pranoje: unë jam njeri, prandaj kam ndjenja të forta seksuale. Është problem po nuk pate, sepse ka diçka që nuk shkon tek ti. Por Perëndia te ka krijuar me dëshira seksuale. Qysh kur krijoi njeriun e parë, Ai nuk e krijoi Evën, gruan e parë, dhe ia dërgoi Adamit, që pastaj Adami të thoshte: "Po çfarë i bëhet kësaj? Një gjë i bëhet, po çfarë i bëhet?" Perëndia, që e krijoi seksin, e di që është gjë e mirë, por mos harro që Perëndia ka vendosur kufizime në lidhje me të.
3. **Duhet të di se cilat janë gënjeshtret e kësaj bote.** Nëse do të rezistosh tundimit, duhet të dish se cilat janë gënjeshtret, sepse do t'i hasësh shumë shpesh. Bibla thotë se Satani, djalli, është babai i të gjitha gënjeshtreve. Ai i gënjen njerëzit dhe i orienton mendimet seksuale sepse e di që po mëkatuan nga ana seksuale, ata do t'i kthejnë shpinën Perëndisë për fare. Djallit i pëlqen, sepse pastaj njerëzit ndihen fajtor gjatë gjithë jetës për atë që bënë. Djalli përdor mashtrimin si një mjet të tij.

P.sh., çiftet e martuar thonë: "Po ku do e marrë vesh njeri?" Ky është mashtrimi i djallit. "Nëse të bën të ndihesh mirë, pse e frenon veten?" Mashtrim. Mos

harro se për çdo mëkat ka pasoja, gjithmonë, qofsh beqar, i premtuar dikujt, apo i martuar.

4. **Ti mund ta kontrollosh veten.** Shpesh njerëzit e përdorin si justifikim: "Po, se kontrollova dot veten. U përfshiva shumë." Po, kontrollohet vetja. Perëndia na ka dhënë diçka brenda vetes që quhet vet-kontroll, forca e vullnetit. Disa thonë: "Ti se kupton, se ti je i martuar, por nuk kontrollohet vetja." Nëse je tip i tillë që thua nuk kontrollohet vetja, le të sajojmë një situatë.
Ti je në një ditëlindje ose pub, dhe njeh një vajzë shumë seksi pas festës. Ajo të fton në shtëpinë e saj, dhe ti e kupton se ku po shkon muhabeti. Sa hyn në shtëpi, shkon në krevat dhe ajo thotë: "Dua të them diçka. Më duket se jam me sida, po s'jam shumë e sigurt. Harrova të të them, por unë jam vajza e pronarit ku punon ti, dhe qenka ora 12, tani më vjen i dashuri, ai është i krisur sepse sapo ka dalë nga burgu." Në atë moment, a do ta lëshosh veten dhe të thuash: "Jo, po s'kontrollohet vetja"? JO. Ti në atë moment do të zbulosh diçka tek vetja jote që quhet vet-kontroll. Ti e kontrollon veten aq shumë në atë situatë, sa edhe Gandi do të dukej si ngordhalaqi i lagjes. Ti mund ta kontrollosh veten. Besoje, sepse Perëndia e ka vënë Brenda teje këtë gjë.
5. **Në planin tim për t'iu shmangur tundimit, duhet të di dhe kufizimet e mia.** Nëse je në një lidhje apo shumë afër saj, vendos disa kufij para se të përfshihesh shumë. Nëse e lëshon veten dhe je me personin që do, nuk llogjikon më si duhet. Për një grua, i gjithë procesi do 20-30 minuta; për një mashkull, 1.5 sekonda. Kështu që vendos ato limite përpara, kufijtë. Kur je në mes të puthjes, nuk ka më kohë për të ndaluar apo për të folur, sepse goja është e zënë. Pra, vendos kufij, kaq dhe pikë.
6. **E fundit, shoqëria e mirë të ndihmon të shmangesh tundimeve.** Kështu që zgjidhe shoqërinë me kujdes. Sepse, po qeve me shoqërinë e gabur, ata puthen në lokal mu para fytyrës tënde, dhe ti me të dashurën, çfarë do bësh? "Kam dhëmbët pa larë sot." (shaka) Kërko ndihmën e një shoku, miku, nëse je në një situatë delikate të tillë. Lidhja juaj po keqësohet, ke ndjenja të rënda faji për mëkatet e së shkuarës, po bashkëjeton me dikë dhe e di që s'është gjëja e duhur. Ke probleme me pornografinë? Vetëm thuaj, "Kam nevojë për ndihmë." Unë me gruan time, ose (një çift nga kisha), jemi gati për të folur me ju, për t'u lutur bashkë, për t'ju këshilluar nëse është e nevojshme.

4. Ndero Perëndinë duke nderuar të tjerët.

Pali tha, "Jetoni në shenjtëri dhe me nder."

Kur nderojmë njëri-tjetrin në marrëdhëniet tona, kemi nderuar Perëndinë. Qofshin këta shokë, apo e dashura/ri, burri/gruaja. Kur ti nderon dikë, ke nderuar Perëndinë. Ti tregon respekt ndaj Perëndisë duke respektuar ata.

Djem, mënyra sesi i shikojmë vajzat dhe gratë e bukura në rrugë nuk është respekt, as nderim; quhet epsh. Kur kalon ajo e bukura afër teje, dhe ti bën vlerësimin me sy nga lart poshtë në pjesët e tua të preferuara të trupit, ai nuk është nderim. Plus, na tregon shumë të ulët ne burrat kur na shikojnë të tjerët duke vëzhguar dikë, veç po pate vënë syze dielli që s'e kuptojnë.

Kjo është shumë e vështirë, sepse ne meshkujt jemi vizualë dhe na duket e natyrshme. Por nëse duam që Perëndia të na ndryshojë dhe të transformojë karakterin tonë për t'u bërë si i Krishti, vendos që nuk do "skanosh" pjesët që do tek një femër në rrugë. Shikoji ashtu siç i sheh Perëndia. Ky quhet nderim.

Gocat, edhe ju i shikoni cunat. Ndoshta mendoni se ju gocat nuk i vëzhgoni djemtë shpesh, por ka shumë raste kur unë ndihem në siklet në praninë e gocave sepse e shikoj që po skanojnë. Gjithashtu, mendoj se gocat nuk i respektojnë djemtë nëse ato vishen në mënyrë provokative, në mënyrë që të kërkojnë vëmendje për trupin e tyre.

Syri është dritarja e shpirtit. Sytë janë reflektimi i mirësisë së Jezus Krishtit në jetën tuaj. Nëse dikush nuk të shikon në sy, a do ta marrësh vesh se çfarë ka brenda atij personi?

Gocat thonë, "Vëzhgimi nuk është puna jonë; janë punësuar djemtë për vëzhgimin e gocave." E vërtetë është që meshkujt janë më vizualë. Por, nëse një gocë ka veshur një bluzë që i bën një fëmijë 4-vjeçar, çunat bëhen kuriozë për mënyrën se si i rri dhe sa e zbuluar është. Nuk po mbroj djemtë. Goca, ju nuk keni idenë se sa shumë karikohen djemtë vetëm duke parë. Nuk e kuptoni që duke u veshur në një mënyrë të tillë, ndonjëherë djemtë në mendjen e tyre mund të imagjinojnë lakuriqësinë tuaj.

Pra, ndihmojmë njëri-tjetrin. Unë besoj se Perëndia dëshiron që unë të nxis ty të afroresh më shumë tek Ai, dhe ti duhet të më nxisesh mua të afrohem më afër Zotit.

Ndoshta, ndërsa flasim për të kaluarën, ndonjëri nga ju ka ndjerë siklet për shkak të mendimeve të turbullta dhe situatave të kaluara: "Unë vetëm i shenjët që s'jam." Nëse je në një situatë të tillë, ky është Perëndia që të thotë, "Unë dua ta heq fajin nga ti."

Ndoshta dikush e ka tepruar në jetën e tij dhe ndjen veten shumë larg nga gjithçka që po themi. Mos harro se kush afrohej më shumë afër Jezusit: njerëzit

që kishin pasur probleme seksuale, prostitutat, dhe ajo gruaja tek pusi që kishte pasur pesë burra. Ashtu si Jezusi i fali ata dhe u tha, "Shko dhe mos mëkato më," Perëndia do të falë ty sot. Ai dëshiron të vendosë këmbët e tua në rrugën e duhur. Ai dëshiron ta rindërtojë jetën tënde nga e para.

Sot, lejoje Perëndinë të vijë në jetën tënde dhe të rindërtojë pastrinë tënde të brendshme, anën seksuale të jetës tënde, dhe shenjtërinë tënde.

Fundi i vargut 7 thotë: *"Perëndia na thirri në shenjëri. Na ka ftuar të jemi të shenjtë."*

Perëndia po të fton ty për të pasur intimitet me Të. Ai të njeh me emër, Ai ka gati përgjigjet për lutjet tua, dhe është gati për të të ndryshuar ty.

Sfida ime është kjo: nëse duam të ikim nga këtu ndryshe nga si erdhëm, atëherë lejoje Perëndinë të bëjë diçka në jetën tënde. Pranoje thirrjen e Tij dhe hap zemrën për transformimin që Ai dëshiron të sjellë në jetën tënde.

Le të lutemi.